

**V E N D I M**  
**Nr. 545, datë 6.10.2000**

**PËR SHPRONËSIMIN PËR INTERES PUBLIK TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, TË  
CILAT PREKEN NGA NDËRTIMI I SEGMENTIT RRUGOR TIRANË-VORË, NË  
TERRITORIN E BASHKISË SË VORËS, PJESË E SUPERSTRADËS RRUGORE TIRANË-  
DURRËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe në zbatim të nenit 5, pika 1, të nenit 20 dhe nenit 21, të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik”, me propozimin e ministrit të Transportit, Këshilli i Ministrave

**V E N D O S I:**

1. Shpronësimin për interes publik të pasurive të paluajtshme të pronarëve, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor Tiranë-Vorë, pjesë e superstradës rrugore Tiranë-Durrës.
  2. Shpronësimi të bëhet në favor të Ministrisë së Transportit.
  3. Pronarët e pasurive të paluajtshme që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës së kompensimit përkatës, i cili paraqitet në tabelën, që i bashkëlidhet këtij vendimi, në shumën e përgjithshme prej 4 919 250 (katër milionë e nëntëqind e nëntëmbëdhjetë mijë e dyqind e pesëdhjetë) lekë.
  4. Fondi për kompensimin e pronarëve të shpronësuar, sipas pikës 3 të këtij vendimi, të përballohet nga buxheti i shtetit, i miratuar për vitin 2000, për Ministrinë e Transportit, në zërin “Shpronësime”.
  5. Shpronësimi të përfundojë brenda datës 30.11.2000.
  6. Ngarkohet Ministria e Transportit për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Ilir Meta**

| Nr.    | Emri                    | Sipërfaqja në m2 |        | Çmimi në L/m2 | Vlera në lekë  |
|--------|-------------------------|------------------|--------|---------------|----------------|
|        |                         | Tokë Bujq.       | Truall |               |                |
| 1.     | Shehap Hamdi Krasniqi   |                  | 73 m   |               | 894 50 (70%)   |
| 2.     | Sulejman Hamdi Krasniqi |                  | 94 m   |               | 1 645 000      |
| 3.     | Hamdi Rexhep Krasniqi   |                  | 136 m  | 175 00        | 2 380 000      |
| Shuma: |                         |                  | 303 m2 |               | 4.919.250 lekë |